



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/21

Datë: 01.04.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-220 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-112 për Tatimin e Normës së Akcizës në Kosovë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 1 prill 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit të Qeverisë nr. 16/20 të datës 24.03.2015

1. Plotësohet dhe ndryshohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.16/20 i datës 24.03.2015 si në vijim:
 - 1.1. Te paragrafi 2.1. para pikës së parë shtohet pika si vijon:
 - Veturat e reja të peregjistruara do të jenë të liruar nga tatimi i akcizës.
 - 1.2. Te paragrafi 4. pika e parë ndryshohet si vijon:
 - 24021000 Cigaret, cigaret e prera dhe cigarelloset të cilët përmbajnë duhane në shumë prej 1.10 euro për njësi konvencionale.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe Dogana e Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi pas konsultimeve të zhvilluara në Komisionin për Buxhet dhe Financa.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë